

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR ECURINË E PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE, 3 KORRIK 2005 NË SHQIPËRI

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është organizata e parë joqeveritare e krijuar në Shqipëri. Ai u themelua në 19 dhjetor të vitit 1990, si “Forumi për Mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut” dhe është regjistruar me vendimin nr. 17/1 të Ministrisë së Drejtësisë. Në 22 Mars 1992, organizata u anëtarësua në Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, duke marrë dhe emrin që ka sot. Pas miratimit të ligjit “Mbi organizatat jo-fitimprurëse”, KSHH u regjistrua pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor të Tiranës.

Misioni kryesor i KSHH-së është:

- ⇒ *Vëzhgimi* i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.
- ⇒ *Sensibilizimi* i opinionit publik mbi të drejtat politike, shoqërore, civile dhe kulturore, mbrojtjen e tyre dhe procedurat që duhen të ndiqen në rast se këto të drejta dhunohen.
- ⇒ *Reagimi* kundrejt shkeljeve të akteve ligjore të brendshme dhe ndërkombëtare që i përkasin kësaj sfare nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike, kontakteve të drejtpërdrejta ose raporteve drejtuar autoriteteteve përkatëse me qëllim që të vemë në vend të drejtat e dhunuara.
- ⇒ *Përmirësimi* i legjislacionit dhe praktikës për zbatimin e ligjit nëpërmjet oponencave dhe rekomandimeve si në fazën e draftimit të tyre, ashtu edhe gjatë zbatimit të tyre.
- ⇒ *Reagimi për ritjen e përgjegjshmërisë* së administratës publike në zbatimin me korrektësi të ligjit dhe për përmirësimin e situatës të të drejtave të njeriut.
- ⇒ *Botimi* i raporteve mbi situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri; informacione në formë fletëpalosjesh, kartash ligjore, broshurash, guidash etj; buletine dhe raporte tremujore në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.
- ⇒ *Mirëmbajtja* e një databazë me materiale ligjore për të drejtat e njeriut si dhe të dhëna për shkeljet e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe burgjet dhe komisariatet e policisë në veçanti.

KShH-ja gjatë gjithë veprimtarisë së tij ka monitoruar të gjitha proceset zgjedhore që janë zhvilluar në Shqipëri.

KShH-ja vlerësoi rëndësinë e zgjedhjeve të zhvilluara në 3 korrik 2005, dhe ndoqi me kujdes hapat më të rëndësishëm në përgatitjen e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, ngritjes së administratës zgjedhore, fushatën elektorale, procesin e votimit si dhe procesin e numërimit të votave.

Në zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005, KShH-ja aktivizoi 116 vëzhgues afatgjatë të akredituar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ-së), dhe 7 vëzhgues të huaj afatshkurtër. Ata u trajnuan për Kodin zgjedhor dhe në mënyrë të veçantë për metodologjinë e vëzhgimit.

Vëzhguesit e KShH-së monitoruan ecurinë e fushatës zgjedhore në disa rrethe¹, faktin nëse anëtarët e Komisioneve Zonale të Zgjedhjeve (KZZ) trajnoheshin, ngritjen dhe trajnimin e anëtarëve të qendrave të votimit, listat përfundimtare, ushtrimi i të drejtës së zgjedhësve për tju drejtuar gjykatës në rast se emri i tyre rregjistrimit me vendim gjykatë të zgjedhësve të mbetur jashtë listës përfundimtare të votimit, marrja e materialeve zgjedhore që KQZ-ja duhej t'i dërgonte KZZ-ve, etj.,

KShH-ja monitoroi rreth 1000 qendra votimi në rrethet kryesore të vendit (me ndërprerje), ndër të cilat u përfshinë edhe 4 burgje dhe 6 vende paraburgimi. Gjithashtu, KSHH-ja ka monitoruar **25 qendra të numërimit të votave** në KZZ-të të përfshira në zonat ku u shtri vëzhgimi.

KSHH nëpërmjet këtij raporti paraqet përfundimet paraprake lidhur me aspekte të veçanta për ecurinë e procesit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005 në zonat zgjedhore ku është shtrirë vëzhgimi i KSHH -së

Falenderime²

KSHH-ja falenderon të gjithë vëzhguesit e tij dhe korrespondentët në 7 rrethet më kryesore të vendit për profesionalizmin, paanshmërinë, përkushtimin, komunikimin me etikë të vërejtjeve në qendrat e votimit.

KSHH-ja falenderon gjithashtu **KQZ-në për akreditimin e shpejtë të vëzhguesve të KShH-së dhe për informimin dhe vënien në dispozicion të udhëzimeve dhe informacioneve të nevojshëm për vëzhgim.**

KSHH-ja përshëndet **z. Alfred Mosiu, President i Republikës së Shqipërisë** për nismën e ndërmarrë për hartimin e **Kodit të etikës** për zgjedhjet parlamentare si dhe për vëmendjen e veçantë që i kushtoi vëzhguesve vendore.

¹ Qëndrat e votimit të vëzhguara janë përfshirë në rrethet Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Elbasan, Korçë, Gjirokastër, Sarandë (pjesërisht), Kukës, Vlorë, Pogradec. Qëndrat e votimit në burgjet Lezhë, Vaqar, Peqin, Rrogozhinë, dhe 325 Tiranë dhe në institucionet e paraburgimit 313 dhe 302 Tiranë, Lezhë, Shkodër, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës dhe Vlorë.

² KSHH-ja përfiton nga rasti të falenderojë Fondacionin e Shoqërisë së Hapur (SOROS), Komitetin Suedez të Helsinkit dhe CORDAID për mundësinë që i krijuan organizatës për të mbështetur kryerjen e vëzhgimeve të zgjedhjeve parlamentare të 3 korrik 2005.

1. Kuadri ligjor

Zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005 u zhvilluan në bazë të kodit zgjedhor, të ndryshuar në janar 2005. Kuvendi ngriti komisionin bipartizan për reformën zgjedhore. Si ngritja edhe puna e tij ishin të vonuara. Dy ishin problemet që shkaktuan vonesa të theksuara: a) Përbërja e KQZ-së dhe b) Ndarja e zonave elektorale. E para u zgjidh me konsensus duke vendosur mbarimin e parakohshëm të mandatit të një anëtari të KQZ-së dhe zëvendësimin e tij me një kandidat të propozuar nga opozita, ndërsa çështja e tjetër u shty për t'u zgjidhur më vonë.

Jo vetëm ndryshimet e Kodit Zgjedhor u bënë me vonesë, por edhe ligji për ndarjen e zonave u miratua në fillim të Marsit 2005, gjë që deri në një farë mënyrë ndikoi edhe në ngritjen me vonesë të KZZ-ve. Gjithashtu, vonesa u vunë re në përgatitjen e listave paraprake, shpalljen e tyre, rregjistrimin e subjekteve zgjedhore, ngritjen me vonesë të komisioneve të qendrave të votimit, etj.. Këto procese u shoqëruan shpesh me debate të ashpra politike.

2. Administrata zgjedhore

KSHH-ja ka ndjekur me vemëndje veprimtarinë e **Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ-së) dhe konstaton se ajo u karakterizua nga profesionalizimi, objektiviteti dhe transparencia, paanshmëria dhe operativiteti.** Shkelja e disa afateve ligjore ka qenë pasojë e faktit se disa nga partitë politike nuk kanë zbatuar kërkesat lidhur me afatet për propozimet e anëtarëve të KZZ-ve dhe KQV-ve. Edhe gjatë procesit të votimit, KQZ-ja demonstroi profesionalizëm dhe vullnet për të administruar procesin e votimit sipas standarteve të kërkuara. Udhëzimet e KQZ-së kanë ndihmuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Ankesat drejtuar KQZ-së kanë qenë të shumta, megjithëkëtë ai ka qenë angazhuar për ti shqyrtuar ato brenda afateve ligjore.

Komisionet e zonave zgjedhore (KZZ-të) për zgjedhjet parlamentare 2005, siç u përmend më lart u ngritën me vonesë. Sipas ligjit, afati i fundit i tyre ishte më 3 mars 2005, ndërkohë që gjashtë partitë përkatëse politike që kishin të drejtë të bënin propozime e ushtruan këtë të drejtë me vonesë. Si pasojë edhe trajnimi i tyre u bë me vonesë.

Trajnimi i komisionerëve

Disa të meta dhe shkelje të dispozitave ligjore të vëna re në qendrat e votimit të vëzhguara nga aktivistët e KSHH-së, **kanë të bëjnë me trajnimin jo-cilësor dhe jo të mjaftueshëm të anëtarëve të KZZ-ve për shkak të mosparaqitjes së propozimeve nga partitë politike përkatëse dhe ngritjes së tyre me vonesë.** Për të njëjtin shkak, me vonesë u ngritën edhe KQV-të (në shkallë vendi afërsisht 4700 anëtarë). Kjo vonesë pati ndikim në zgjedhjen e problemeve që lindën gjatë ditës së votimit.

Regjistrimi i partive jo-parlamentare dhe kandidatëve

Për zgjedhjet parlamentare 2005 u rregjistruan 27 subjekte zgjedhore, 1230 kandidatë për deputetë. Sipas ligjit, partitë e rregjistruara si subjekte zgjedhore ishin të detyruara të paraqesnin një listë kandidatësh për 40 vende në Kuvend dhe se lista duhet të mbështetej nga 7000 firma të

votuesve. Nga verifikimet e bëra nga KQZ-ja rezultoi se disa firma ishin të falsifikuara. KShH-ja me anë të një deklaratë publike i kërkoi KQZ-së të bëjë verifikimet e nevojshme³.

Në këto zgjedhje u vu re se kandidatë të një forcë politike u regjistruan nën siglën e një partie tjetër. Edhe në spotet dhe materialet informuese të këtyre forcave, të shpërndara ose të bëra publike në mjedise të ndryshme, u vu re ky fenomen.

3. Listat e zgjedhësve

Sipas Kodit zgjedhor (neni 64/2 pika 2) listat paraprake duhej të shpallehin jo më vonë se data 31 mars 2005. Në rrethet e vëzhguara nga KSHH, **listat paraprake u shpallën me disa ditë vonesë**. Pas shpalljes së listës paraprake, kryetarët e njësive vendore duhet të bënin njoftimin me shkrim të zgjedhësve. Në përgjithësi në shumicën e qyteteve të monitoruara njoftimet me shkrim të zgjedhësve u bënë nga kryetari i bashkisë por në komuna ka patur mjaft probleme, pasi ka patur një indeferentizëm nga organet e pushtetit vendor. Nga ana tjetër, u vu re një indiferentizëm nga ana e zgjedhësve për të kontrolluar në kohë nëse emrat e tyre ishin në listë dhe për të kërkuar ndryshimet e mundshme në rast mungese të emrit të tyre në listën përfundimtare.

Afati i fundit për shpalljen e listave përfundimtare ishte jo më vonë se data 13 qershor 2005. Listat në shumicën e zonave u shpallën në afatin e përcaktuar ligjor me përjashtim të disa QV në disa zona në Tiranë (Nr. 40, 33, 36) për të cilat nuk u bë shpallja e listave përfundimtare në afatin e përcaktuar.

Listat përfundimtare gjithashtu u ndanë dhe u afishuan në vendet e përcaktuara, pranë pothuaj të gjitha qendrave të votimit me përjashtim të ndonjë rasti sporadik si në disa QV të disa zonave në Tiranë (Nr. 33, 40, 37), për të cilat këto lista nuk janë afishuar. Ka patur raste të hasura gjatë vëzhgimit tonë se disa nga listat e afishuara janë grisur.

Në këto zgjedhje u bë një punë më e mirë për hartimin e listave të zgjedhësve megjithëse përsëri u vërtetuan mungesa, pasaktësi dhe dyzime emrash. Një pjesë e listave u korrigjuan pas shpalljes së listave paraprake, ndërsa një pjesë tjetër nëpërmjet vendimeve gjyqësore të cilat mund të jepeshin jo më vonë se 6 orë para mbylljes së votimit.

Ashtu sic u përmënd me sipër në rastet kur zgjedhësi nuk gjen emrin e tij në listat mund ti drejtohet gjykatës së rrethit. Raste të tilla janë vënë re në gjykatat e shkallës së parë të disa rretheve si në Tiranë, Fier, Korçë, Gjirokastrë, etj.

Procedura e marrjes së vendimit për të votuar ishte e tillë: mblihdeshin të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe më pas do të hidhej shorti si dhe do të merreshin vendimet nga gjyqtarët e përcaktuar me short.

Interesimi i zgjedhësve për t'u njohur si me listat paraprake ashtu dhe me ato përfundimtare është në përgjithësi jo i lartë kjo pothuajse në të gjitha zonat e vëzhguara nga KSHH.

Ka patur raste kur lista e personave të dërguar KQZ-së nga bashkia të mos përputhej me atë të dërguar nga KQZ-ja, si në komisariatit e Korçës, paraburgimin e Vlorës ku një numër i konsiderueshëm të paraburgosurish nuk gjenin emrin në listë.

³ Deklarata e KShH-së “Mosrespektimi i afateve ligjore mund të çënojë standartet zgjedhore”, datë 28 Maj 2005. Për më shumë mund të shihni deklaratat në faqen e internetit të KShH-së www.ahc.org.al

4. Ngritja e KZZ-ve dhe trajnimi i anëtarëve të tyre

Pavarësisht se afati i fundit për ngritjen e KZZ-ve ishte sipas Kodit Zgjedhor data 3 Mars 2005, në asnjë nga 100 zonat zgjedhore nuk u ngritën në afatin e përcaktuar. Kjo vonesë ka ardhur si rezultat i disa faktorëve si ndarja me vonesë e zonave zgjedhore, si dhe bërja me vonesë e propozimeve nga ana e subjekteve politike për anëtarët e KZZ-ve.

Trajnimi i anëtarëve të KZZ-ve siç është përmendur dhe në sipër u bë me ngut si rrjedhim kemi mendimin se ai nuk ishte cilësor. Kjo u vërejt në praktikë gjatë kryerjes së detyrave të tyre në procesin e numërimit të votave dhe në shpalljen e rezultateve.

5. Fushata zgjedhore

⇒ *Situatë e përgjithshme*

Sipas nenit 133 të Kodit zgjedhor, fushata elektorale duhet të fillojë 30 ditë përpara ditë së zgjedhjeve, pra konkretisht në datën 2 Qershor 2005.

Në fillimet e saj, **fryma e fushatës zgjedhore ishte relativisht e qetë**. Fushata zgjedhore është zhvilluar lirisht dhe pa pengesa në të gjitha zonat e monitoruara nga KShH, me përjashtim të ndonjë të ndonjë incidenti të ndodhur, (si rasti i thyerjes së zyrës elektorale të kandidatit të PD-së, Spartak Ngjela, zona 41). Në krahasim me zgjedhjet e kaluara, pozitiv ishte zhvillimi i debateve televizive dhe shpalosja e programeve dhe alternativave të çdo subjekti zgjedhor. Megjithë fillimet e mbara, fushata zgjedhore, sidomos në prag të afrimit të ditës së votimit u ashpërsua, u rrit tensioni si dhe u shoqërua me akuza të ndërsjella. **U vunë re shkelje të kodit të etikës nga subjekte zgjedhore dhe kandidatët e tyre**. Pati raste ku u shënuan incidente në formën e grisjes së posterave, grindjeve dhe rrahjeve ndërmjet shtabeve të kandidatëve.

Gjatë kësaj fushate ranë në sy **shpenzimet e mëdha të subjekteve zgjedhore gjatë fushatës elektorale, sidomos të atyre të partive të mëdha**. KShH-ja inkurajon zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me verifikimin e burimeve financiare të fushatës.

Gjuha e kandidatëve në mbledhje, mitingje apo aktivitete të tjera të përfaqësuesve partiake ka qënë kryesisht e ekulibruar, megjithatë ka patur raste si në Fier apo dhe në ndonjë vend tjetër ku gjatë debatit në një TV lokal, TV Apollonia për zonën elektorale Nr. 72 u vu re që të dy kandidatët për deputetet e LSI dhe PS-së kanë përdorur gjuhë fyese, duke thyer kështu kodin e etikës. Çështja ka përfunduar në gjykatë me akuzën e shpifjes.

Vendosja e **afisheve ose materialeve të ndryshme propagandistike** është bërë lirisht pothuajse në të gjitha qytetet, të cilat nuk janë grisur. Nuk ka patur raste të **propagandës zgjedhore** nga të huajt.

⇒ *Ngritja e qendrave të votimit*

Gjatë vëzhgimit të kryer pothuajse në të gjitha zonat e vëzhguara **nuk kishte raste që qëndrat e votimit të jenë ngritur në ndërtesa private pa autorizim të KQZ-së** në këto zona.

Nuk kishte raste që qëndrat e votimit janë ngritur në ndërtesa që përdoren nga administrate publike (përjashto institucionet arsimore dhe shëndetësore), kjo pothuajse në të gjitha zonat e vëzhguara me përjashtim të 2 QV në Vlorë të cilat janë ngritur jashtë qendrave arsimore dhe shëndetësore në zonën 94 dhe 95).

Në përgjithësi nuk ka patur raste që qëndrat e votimit të jenë ngritur në ndërtesa që janë në pronësi pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike ose kandidati ose të afërmeve të tij fakt ky i vëzhguar në disa zona, me përjashtim të ndonjë qendër votimi në Shkodër si dhe në Tiranë⁴.

⇒ Ngritja e Komisioneve të Qëndrave të votimit dhe trajnimi i tyre⁵

Ngritja e komisioneve të qëndrave të votimit duhet të bëhet jo më vonë se data 23 qershor 2005. Për ngritjen e komisioneve të qëndrave të votimit, Kodi zgjedhor kërkonte bërjen e propozimeve të subjekteve politike për anëtarë të KQV-ve jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve. Ndërsa KZZ-ja duhet ti emërojë anëtarët jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve. Me çdo rast emërimi i tyre bëhet jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve.

Propozimet në disa zona të vëzhguara nga KSHH janë bërë brenda afatit të përcaktuar ligjor, por ka patur dhe zona të cilat propozimet janë bërë me vonesë si **në Tiranë** (zona 37, 42, 32), **Pogradec** (zona 85), **Durrës** (zona 30), **Shkodër** (zona Nr.4 dhe 5), **Elbasan** dhe **Gjirokastrë**.

Ngritja e KQV-ve është bërë në afatin e caktuar në disa zona, megjithatë ashtu si dhe propozimet që janë bërë me vonesë, dhe ngritja e tyre është bërë jashtë afatit të përcaktuar, si **Tiranë** (Zona 33, 36, 37, 42, 32), **Pogradec** (zona 85), **Durrës** (zona 30), **Shkodër** (zona 4, 5), **Elbasan**.

Trajnimi i komisioneve të qëndrave të votimit është zhvilluar nga KQZ në ditët e fundit të muajit qershor nëpërmjet një plani trajnimi, duke e organizuar trajnimin e tyre në disa raunde, në nivel kombëtar, qarku, dhe prefekturë.

⇒ Ngritja e grupeve të numërimit dhe trajnimi i tyre⁶

Sipas udhëzimeve të KQZ-së, KZZ-të duhet të përcaktonin numrin e grupeve të numërimit, jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve, dhe këtë duhet ta komunikojnë menjëherë partive përkatëse politike që të bëjnë propozimet. Ky udhëzim jo vetëm nuk është zbatuar nga të gjithë KZZ-të por edhe propozimet u bënë me vonesë të theksuar. Trajnimi ose nuk u bë ose ishte formal, gjë që reflektoi në praktikë ditën e numërimit të votave.

Ndërsa ngritja e tyre duhet të bëhet jo më vonë se dy orë përpara përfundimit të votimit, afat ky që në mënyrë të detyrueshme është zbatuar, por ky afat i përcaktuar nga ligji nuk është eficient për trajnimin e anëtarëve të grupeve të numërimit.

⇒ Materialet logjistike për ditën e votimit

Materialet logjistike u janë dhënë KZZ-ve nga KQZ-ja në kohën e përcaktuar nga Kodi zgjedhor, jo më vonë se 3 ditë nga dita e votimit, 29 Qershor 2005, ndërsa KQV-ve duhet tu jepeshin këto materiale jo më vonë se 15 orë nga ora e fillimit të votimit.

⇒ Heshtja zgjedhore

⁴ Në zonën Nr.6, një QV është ngritur në shtëpinë e një personi që mendohet të jetë anëtarë i PD-së si dhe në Tiranë një QV ishte ngjitur me një shtab elektorale, për të cilën është marrë vendimi në ditët në vijim nga KQZ.

⁵ Shih deklaratën e KSHH-së lidhur me këtë çështje “Kur do të ngrihen Komisionet e qëndrave (KQV-të)”, datë 23 qershor 2005

⁶ KSHH ka reaguar nëpërmjet një deklarate “Kur do të ngrihen dhe kur do të trajnohen grupet e numërimit të votave?!” datë 24 qershor 2005 si dhe deklarata “Edhe njëherë për grupet e numërimit të votave”, datë 6 qershor 2005

Me heshtje zgjedhore do të kuptojmë sipas ligjit (24 orë para fillimit të procesit të votimit fillon heshtja zgjedhore), duhet të mos bëhet propaganda zgjedhore. Në këto zgjedhje heshtja zgjedhore u respektua por pati dhe raste sidomos në ditën e votimit ku jo vetëm komisionerët e subjekteve politike bënin propagandë në qendrat e votimit dhe të numërimit por ka patur raqte që kandidatët të partive politike kanë bërë deklarata të cilat kishin përmbajtje propagande zgjedhore si: dhënia e deklaratave në median elektronike të kandidatëve të partive politike për rezultatet e arritura, në momentin kur procesi i votimit ende nuk kishte përfunduar.

6. Media gjatë fushatës dhe procesit të votimit

Në përgjithësi, media elektronike dhe ajo e shkruar, kombëtare dhe lokale mbuloi fushatën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare, korrik 2005. Sensibilizimi i publikut ishte i mirë. Në disa raste, spotet televizive të partive ishin të ashpra dhe cënonin etikën. Për kontrollin e medias dhe mbulimin e fushatës nga ana e saj u vendos dhe një komision mbikqyrës i medias.

Gjatë ditës së votimit, media bëri një mbulim të plotë të ecurisë së këtij procesi. U konstatuan raste të cënimit të heshtjes zgjedhore nga subjektet gjatë deklaratimeve publike për median.

7. Situata e përgjithshme e zhvillimit të zgjedhjeve

Zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005 u zhvilluan në një situatë përgjithësisht të qetë, megjithëse u verifikuan disa incidente në zona të caktuara. **KSHH-ja vlerëson maksimalisht pjesëmarrjen masive të zgjedhësve shqiptarë në këto votime, qytetarinë dhe përgjegjshmërinë e tyre në këtë proces.**

Edhe në këto zgjedhje, partitë politike megjithë pranimin e Kodit të etikës e cënuan atë qoftë gjatë fushatës elektorale edhe gjatë ditës së votimit. **Kishte komisionerë që nuk treguan përgjegjshmëri dhe vullnet politik gjatë ditës së votimit ç'ka solli moszhvillimin e zgjedhjeve në disa qendra votimi.**

8. Policia e shtetit

Nga vëzhgimet e KSHH-së rezultoi se punonjësit e policisë së shtetit **kanë kryer me korrektësi detyrat e ngarkuara nga Kodi Zgjedhor dhe udhëzimi përkatës i KQZ-së**, ndërkohë si gjatë zhvillimit të fushatës, vecanërisht ditën e votimit, policia ka garantuar rendin dhe zhvillimin normal të të gjitha tubimeve të organizuara nga subjektet zgjedhore, si dhe ka garantuar rendin gjatë ditës së votimit duke u garantuar qytetarëve, ushtrimin në mënyrë të qetë të drejtën e votës.

9. Mosngritja e disa qendrave të votimit në institucione të posaçme dhe ndryshimi i vendndodhjes të disa të tjerave

KSHH-ja gjatë vëzhgimit konstatoi se vendndodhja e disa qendrave të votimit ndryshoi në momentet e fundit. Në **disa komisariate policie si: të Elbasanit, Gjirokastrës dhe Kukësit, maternitetin e ri të Tiranës (zona 41) nuk u ngritën qendrat e votimit** me pretendimin se KQZ nuk ishte njoftuar paraprakisht për numrin e personave në këto institucione të veçanta. Disa qendra votimi të vëzhguara ishin vendosur në lokale të papërshtatshme, cilat kufizonin lëvizjen e votuesve dhe qëndrimin e vëzhguesve. Veç kësaj, kishte qendra votimi me mbi 1000 -1800 zgjedhës, kur sipas ligjit nuk duhet të kishte më shumë se 1000 zgjedhës.

10. Procesi i votimit

⇒ Komisioni i Qëndrës së votimit

Në përgjithësi komisioni gjatë kryerjes së detyrave të tij ka qënë korrekt në respektimin e procedurave, por ka patur raste kur anëtarët e komisionit kanë vepruar jo në përputhje me ligjin ose me detyren dhe kompetencat e një komisioneri⁷. Në disa raste, anëtarët e komisionit kanë përdorur celularët pavarsisht se ishte e ndaluar; ndërmjet tyre ka patur debate, mosmarrëveshje dhe tension⁸.

Sipas ligjit, komisioni i qëndrës së votimit në rast të ndonjë shkeljeje, parregullsie, vërejtje nga vëzhguesit partiak, jopartiak, ndërkombëtar dhe vendor duhet të mbajë procesverbal. Ky rregull nuk zbatohet nga të gjitha qendrat e votimit.

Ka patur raste kur anëtarë të ndryshëm duke mos njohur mirë procedurat, në disa raste u kanë dhënë votuesve fletën e votimit së bashku me kundërfletën duke e bërë kështu të pavlefshme votën e tyre.

⇒ Hapja në kohë e qëndrës së votimit

Qendrat e votimit që KShH ka vëzhguar jo të gjitha u hapën në orarin e caktuar (ora 6:00 e mëngjesit). Kjo për faktin se shumë nga anëtarët e komisionit të qëndrave të votimit kanë ardhur me vonesë në qëndrën e votimit, vonesa këto që zgjaten nga 15 min – 30 min tej afatit. Ka patur raste që në disa qendra votimi një anëtar i komisionit të ketë ardhur dhe disa orë me vonesë. Pavarsisht nga mungesa e tij, procesi i votimit ka filluar. Në momentin e ardhjes së anëtarëve të komisionit bëhej një procesverbal tjetër shtesë⁹.

Ka patur ndonjë rast sporadik ku anëtarët e komisionit janë ndërruar pa autorizim nga KQZ-ja si në QV Nr. 1595 (Bathore).

⇒ Gjendja e qëndrës së votimit

Qendrat e votimit pothuajse në të gjitha rastet kanë qënë në gjendje të rregullt me dyer të vulosura, kutitë kanë qënë të kontrolluara dhe të zbrasura. Janë vulosur kutitë e votimit me kodet e sigurisë në të gjitha QV-të e vëzhguara, është mbajtur në të gjitha rastet procesverbali përkatës. Në të gjitha qendrat është kontrolluar numri i fletëve të votimit të cilat pothuajse në të gjitha rastet ka qënë 2% më shumë se numri i zgjedhësve, përveç rastit të paraburgimit të Vlorës ku kishte më pak fletë votimi se sa të paraburgosurit.

Në të gjitha qendrat materialet e marra në dorëzim u kontrolluan, me përjashtim të ndonjë rasti sporadik, ku anëtarët e komisionit neglizhuan.

Për rrjedhojë u konstatuan, mungesa e neglizhencës e ndonjë regjistri me emrat e zgjedhësve, mosfunksionimi i rregullt i llampës fosforeshente, mungesa e vulës së njomë, mosardhja në kohë e kutive të votimit, etj.

⁷ Më konkretisht në QV-të 1927, 4507, 4508, 1933, 1952, 1949, 1935, 1516, etj..

⁸ Si në QV-të 1910, 1934, 1927, 1452, 1955/1, 1776, 1773, 1818, 1923, 1840, 4493, etj..

⁹ Kjo është vënë re kryesisht në këto qendra votimi, Tiranë (1787, 1785, 2327, 1897, 1867, 2000, 2028, 2029, 1723, 1848, 1773, 1998, 1815, 1814, 1960, 2028, 2029), Kukës (278, 256) Elbasan (1123, 2361, 2361/1, 120, 2355, 2307/1), Vlorë (4451, 4439, 4448, 4473, 4459, 4491/1, 4501, 4507, 4494, 4439, 4473, 4497, 4498, 4496), Korçë (3675, 3638, 3468, 3688), Fier (3004, 3013, 3020) Pogradec (3904), Durrës (1021, 1018), Sarandë (4671/1), komisariati i Fierit, burgu i Lezhës, burgu Vaqarr, paraburgimi i sigurisë së lartë 313.

Udhëzimet e KQZ-së kanë qënë në përgjithësi të afishuara në ambjentet e qendrave të votimit megjithatë gjatë vëzhgimit janë vënë re disa raste kur udhëzimet e KQZ-së nuk kanë qënë të afishuara në këto ambjente si 1890, 1927, 1760, 4474, 4512 (Orikum), 1760.

Lidhur me vendndodhjen e dhomave të fshehta, në disa qendra votimi u ngritën pretendime se vendosja e tyre në pozicionet e caktuara, kompromentonte fshehtësinë e votimit.

Në disa qendra nuk kanë qënë të afishuara listat përfundimtare të zgjedhësve ose kanë qënë të grisura si në qendrën e votimit nr.3337, etj.,

⇒ **Materialet propagandistike**

Vëzhguesit e KSHH-së vunë re se pranë disa qendrave votimi deri në largësinë prej 150 metra kishte patur materiale propagandistike, postera të kandidatëve dhe të partive, të cilat në disa raste janë hequr pas vërejtjeve të vëzhguesve të KSHH-së ndërsa në disa raste të tjera nuk janë hequr¹⁰.

Përveç materialeve propagandistike ka patur raste që në disa qendra votimi të jetë bërë propagandë nga anëtarë të komisionit të qendrave të votimit, nga vëzhgues të partive politike ose dhe nga përfaqësues të pushtetit vendor si në QV-të 1770, 1991, Korçë, 1935. Në disa qendra për shkak të materialeve propagandistike është pezulluar votimi derisa janë hequr nga qendrat e votimit posterat dhe materialet e tjera propagandistike.

Kishte disa qendra të cilat ndodheshin ngjitur me shtabet elektorale si psh 1788, 1790 dhe për të cilat nuk është marrë asnjë masë.

⇒ **Fillimi i procesit të votimit**

Në shumicën e qendrave të votimit, ka filluar në **kohën e duhur** (ora 7:00), ndërsa në disa qendra të tjera votimi ka filluar me disa minuta vonesë¹¹.

Fillimi me vonesë i procesit të votimit të shkaktuara nga hapja me vonesë e qendrave të votimit, ardhja me vonesë e anëtarëve të komisionit, mosnjohja e aspekteve të veçanta të procedurës, mungesa e bazës materiale, etj.

⇒ **Disa zgjedhës që nuk patën mundësi të votojnë**

Një problem që u vu re në zgjedhjet ishte lista e zgjedhësve. Kishte persona që nuk e gjenin emrin e tyre në listë, ose kishte gabime ortografike në shkrimin e emrit (fakt i cili iu privonte këtyre zgjedhësve të drejtën për të votuar), kishte dyzim emrash në qendra të ndryshme, ose në lista gjendeshin emrat e personave të vdekur prej kohësh. Në disa raste u pretendua se ndryshimi ose gabimi i emrave në listë ishte bërë me paramendim. E megjithatë duke krahasuar me zgjedhjet vendore paraardhese, listat e zgjedhësve ishin përmirësuar.

¹⁰ Kjo është vënë re në disa qendra të vëzhguara si në Tiranë 1788, 1770, 1714, 1863, 2140, 2110, 1938, 1933, 1814, 3337, 4250, 3657, Gjirokastër (4248, 4250), Durrës (1021, 1018, Qerret) Korçë (3667, 3657), Vlorë (4439, 4465, 4494, 4493, 4377, 4511), Shkodër (259, 260).

¹¹ Konkretisht në QV Tiranë, 1822, 1991, 1995, 1785, 1786, 1787, 1773, 1714, 1764, 2015, 1787, 1785, 1786, 1987/1, 275, 278, 256, 1773, 1812, 1998, 1968, 1683, 1773, 1814, 1960, 1723, 1922, 2235/1, 4250, 1970, (Gjirokastër), 2361, 2361/1, 1201, 2355, 2307/1, 1804, 1806, 1807, 1797, 1957, Korçë (3675, 3638, 3688, 3468, 3664), Durrës (1021, 1018), Kukës (625), Fier (3030, 3013, 3014), Pogradec (3904), 1862, Vlorë (4474, 4459, 4494, 4495, 4440, 4465, 4491/1), komisariati i Fierit, burgu 302, burgu i Lezhës, komisariati i Shkodrës, burgu Vaqarr, paraburgimi 313, Qerret të Durrësit (QV 1516), burgun e Peqinit, burgun e Vaqarrit, burgu 313, etj.

Ka patur persona të cilët nuk mundën të votojnë për arsyet e lartpërmendura¹². Persona të kontaktuar në qendrat e votimit pretendonin se i kanë patur emrat në listat paraprake, por jo në atë përfundimtare¹³.

⇒ *Paraqitja e dokumentave identifikues*

Në përgjithësi, në të gjitha qendrat e votimit është bërë verifikimi i dokumentit identifikues si pashaportë, certifikatë ose letërnjoftim.

Zgjedhësit shqiptarë nuk ishin të gjithë të pajisur me certifikata të lëshuara gjatë tre muajve të fundit, ose ata zotëronin pasaporta të skaduara. Kjo ka çuar në diskutime të shumta dhe nuk janë mbajtur qëndrime të njëjta nga ana e komisionerëve. Në disa qendra janë pranuar votues me certifikata të vjetra, të cilët nuk kanë qënë të pajisur me ndonjë dokument tjetër¹⁴. Por ka patur raste ku zgjedhësit janë lejuar të votojnë me mjete të palejuara si në QV 1883, ku studentët janë lejuar të votojnë me librezën e studentit. Por në disa të tjera kanë votuar me certifikata e vjetra, si në QV 1897, 1747, 1797, 4448 (Vlorë), etj.,

Në disa qendra të tjera janë kërkuar dokumenta shtesë për të gjithë votuesit pavarësisht se nuk është ngritur ndonjë pretendim nga anëtarët e komisionit¹⁵.

Gjithashtu një qëndrim tjetër te dyzuar, komisionerët e kanë mbajtur lidhur me mosmbajtjen në të gjitha rastet të numrit të certifikatave të personave që votonin me certifikatë ose mosmbajtja e tyre nga komisioni sipas udhëzimeve të KQZ-së. Kjo tregon për një mosinformim të mirë dhe të mjaftueshëm të udhëzimeve të KQZ-se dhe dispozitave ligjore nga anëtarët e komisioneve zgjedhore.

Gjatë vezhgimit në qendrën e votimit nr. 4040, Vlorë si dhe në burgun 325 ka rezultuar votim me certifikata fallso. Në qendrat e votimit janë paraqitur dhe votues me vendim gjykatë të cilët kanë votuar lirisht.

⇒ *Ndalimi i votimit dy herë*

Në përgjithësi është bërë kontrolli i duarve nëse ishin të ngjyrosura, timbrosja e gishtit të madh të majtë, kontrolli i emrit, firmosja në regjistër, pajisja e votuesit me fletët e votimit, etj.

Ka patur raste kur nuk janë ndjekur të gjitha procedurat e mësipërme¹⁶.

⇒ *Procedura të tjera gjatë votimit*

Votimi në përgjithësi u zhvillua mirë. Ka patur disa raste ku zgjedhësi ngatërroi kutinë e votimit (kutia për votimin për kandidatin dhe subjektin politik ishin të ndara) dhe hidhte fletët e votimit në kuti të kundërta. Në raste të tilla komisioni hartonte një procesverbal. Në shumicën e qendrave të votimit kjo ishte rregulluar duke ënë një nga anëtarët e KQV-së i cili i tregonte zgjedhësve kutitë se ku duhej të hidhnin fletën e votimit.

¹² Konkretisht në këto QV 1077, 3013, 4439, 4511, 4584, 4515, 1769, 1862, 4496, 4670, 4649, 4664, 1708, 1720, 3013, 3011, 1750, 1749, 1741, 1921, 1686, 1689/1, 1773, 1964, 1817, 1837, 1814, 1021 (Durrës), 1018 (Durrës), 1977, 2014, 1683/1, 1764, 1890, 1927, 1899, 1771, 1807, 1797, 1490/1, 1957/1 (150 persona), 4507, 4508, 3687, 3664, 1933, 1937, 1949, 1987/1, 1773, 1774, 1960, 1775, 1812, 1968, 1970, 1683.

¹³ Në QV-të 1760, 1759, 1761, 1762

¹⁴ Kjo është vënë re në disa qendra si 1935, 1965, 1996/1, 1961, 1915, 1841, 1814, 4477 (Vlorë), 3675 (Korcë), 1742, 1760, 1759, 1856.

¹⁵ Ky fenomen është vënë re në shumë qendra votimi por më shumë në 1805, 4448 (Vlorë), 1862, 1935, Shkoder, etj.

¹⁶ Si në: QV-të 1862, 1764, 1890, 1736, 1818, 1812, 1925, 1927, 1785, burgu i Vaqarrit, burgu i Rrogozhinës, etj.,

⇒ *Personat të cilët nuk mund të votojnë vetë*

Sipas neni 103, Kodi zgjedhor, në rastin kur një person nuk është në gjendje të votojë vetë atëherë duhet që kryetari i Komisionit të qendrës së votimit të caktojë një person për ta ndihmuar të ushtrojë të drejtën e tij politike. Nuk lejohet që një person të caktohet për të ndihmuar më shumë se një person. Në raste të tilla duhet që personi që nuk mund të votojë vetë të bëjë një deklaratë nëpërmjet të cilës të shprehet se kërkon ndihmë.

Në përgjithësi në shumicën e qendrave të vëzhguara, ka patur keqinterpretim ose mosrespektim të procedurave për dhënien e ndihmës dhe votimin familjar.

Ka rezultuar se kjo e drejtë nuk është respektuar në të gjitha qendrat e votimit¹⁷.

Ka patur raste kur këta votues janë ndihmuar nga persona të huaj, pa vullnetin e tyre, pasi komisioni i QV-së nuk i ka lejuar duke e konsideruar rreth mënyrë të gabuar ndihmën e dhënë familjarët. U vunë re edhe raste kur një person ndihmonte më shumë se një person që nuk mund të votonte vetë¹⁸.

Në shumë raste, ndihma është dhënë nga anëtarë të komisionit të qendrave të votimit, vëzhgues vendor ose vëzhgues të subjekteve politike¹⁹. Në shumicën e rasteve për shkeljet e konstatuara, vëzhguesit e KSHH-së kanë bërë vërejtje me shkrim.

⇒ *Votimi nga personat me aftësi të kufizuar fizike*

Në disa qendra votimi të vëzhguara, disa votues, që për arsye fizike kanë patur vështirësi për të hyrë në mjediset e qendrës së votimit për shkak të mungesës së mjeteve të nevojshme për ta. Në disa raste, anëtari i komisionit ka nxjerrë fletët e votimit jashtë qendrës së votimit, për personin që nuk mund të hynte në mjediset e votimit.

Personat e verbër kanë hasur vështirësi për të votuar dhe për ta nuk është krijuar asnjë lehtësi, pavarësisht nga njoftimet e KQZ-së, se personat e verbër në rrethet Tiranë dhe Durrës, ishin pajisur me fletë votimi të posaçme.

Nga vëzhgimet e KSHH-së rezultoi se në asnjë rast të verbërit nuk votonin me fletë të posaçme për ta.

⇒ *Votimi familjar*

Votimi familjar ka qënë një problem pothuajse në të gjithë qendrat e votimit. Më i përhapur ky fenomen ishte midis bashkëshortëve, sidomos atyre në moshë të madhe²⁰.

Vëzhguesit e KSHH-së kanë bërë vërejtje me shkrim dhe kanë sinjalizuar KQZ-në lidhur me këto shkelje të konstatuara.

⇒ *Votimi i fshehtë*

Në disa qendra votimi, zgjedhësit pretendonin se parimi i votimit të fshehtë, shkelej për shkak të pozicionit të dhomës së fshehtë të votimit si, qenia pranë njëra – tjetrës nga të cilat mund të

¹⁷ Si në QV-të 1771, 3906 – Pogradec, 1960, 1760, 1759, 1761.

¹⁸ Si në QV-të 1927, 1807, 1797, 1764, 1770, Paraburgimi 313, etj..

¹⁹ Në QV-të 1740, 1850, 4448, 1987, 1850, 1921, 3013 - Fier, 1861, 1767, 1934, Burgu i Lezhës, burgu i Vaqarrit, 1764, 1990, 1862, 1850, 1490/1, 1490, 1935, 1995

²⁰ Konkretisht Qv nr. 1761, 1861, 2000, 2028, 2029, 1825, 4459, 1850, 4493, 1822, 1764, 1934, 1927, 1736, 1788, Bradashesh – Elbasan (2379, 2445, 2395, 2394), 1770, 1769, 1490/1, 4447, 4507, 4508, 4448, 3685, 1931, 1933, 1689/1, 1998, 1999, 1995, 1773, 1953, 1926, 1922, 1998, 1797, 1713, Komuna Bicaj (619, 625, 624, 627, 622, 621, 610, 611), 1449 dhe 1449/1 – Durrës, 2018, 4253 – Gjirokastrë, 4671/1 - Sarandë, 1077, 3013, 1759, 1760, 1915, 1723, 1723/1, 1735, etj..

shihej lehtë dhoma tjetër të fshehtë si dhe mund të komunikohet lehtë midis zgjedhësve ose kanë qënë në pozicione të tilla ku mund të shihej nga komisioni zgjedhor.

⇒ *Ambjentet e qendrave të votimit*

Në përgjithësi votimi është zhvilluar në institucione mësimore dhe shëndetësore, ndarja e ambienteve të tyre ka qënë shumë e vogël dhe ka krijuar rradha të gjata dhe kaos gjatë votimit. Ka patur raste kur në qendrat e votimit ka patur flukse të mëdha votuesish²¹.

⇒ *Incidente të ndodhura gjatë procesit të votimit*

Megjithëse zgjedhjet u zhvilluan në një situatë të qetë, gjatë ditës së votimit pati disa incidente rreth qendrës së votimit si në rastet në shkollën Hasan Prishtina, shkollën Mihail Grameno, Tiranë, ose konflikti ndërmjet komisioneve në zonën 88 (Ersekë), QV 4247 (Gjirokastrë), 3650 (Korçë), etj.

⇒ *Forcat e rendit ditën e votimit*

Në qendrat e vëzhguara, pothuajse në asnjë rast nuk ka patur persona të armatosur në qendrat e votimit, madje dhe në rastet kur votonin ushtarakë ose oficerë të policisë, ata nuk u lejuan të votonin të armatosur.

KQV-ve u është dashur të thërrasin për rivendosjen e rendit dhe qetësisë në qendrën e votimit, policinë në disa raste si psh kur qytetarë të ndryshëm kanë dashur të hyjnë dhe të votojnë me dokumenta të parregullta²².

⇒ *Ndërprerje e procesit të votimit*

Në disa qendra votimi, procesi i votimit është pezulluar ose është ndërprerë për disa shkaqe si: prezenca e kandidatëve për deputet në qendra votimi, bërja propagandë nga komisionerë ose nga kandidatë, fluksi i madh i votuesve të cilët kanë çuar në kaos, vendosja e rrjetit kompjuterik për gjetjen e emrit të votuesit nga Organizata ndërkombëtare Marshall por që ka shkaktuar shumë kaos, etj²³.

⇒ *Mbyllja e votimit*

Në përgjithësi në të gjitha qendrat e votimit nuk ka patur shkelje lidhur me zbatimin e procedurave ligjore që parashikon Kodi Zgjedhor lidhur me mbylljen e procesit të votimit.

Në përgjithësi votimi është mbyllur në afatin e përcaktuar ligjor. Por ka patur raste kur procesi vazhdoi pas orarit të parashikuar (ora 19:00). Kjo për shkak të disa faktorëve të përmendur dhe më sipër, siç është fillimi me vonesë i votimit, ndërprerje e votimit për disa minuta, shumë

²¹ Kjo ka rezultuar në QV nr. 1918, shkolla Hasan Prishtina, 1806, 1921, 1925, 1785, 1684, 1977, 1759, 1915, 1714, 1868, 1869, 1988, 1961, etj.

²² Në Qv-të 1723/1, 2018, 4469 (Sarandë), 4501 (Vlorë), 1803, etj.

²³ Kjo është vënë re në disa qendra si 4248, 4250, 4238/1, 1803, 1452/1, 3657, 3659, 3675, 4460, etj.

zgjedhës kanë patur ndryshime të ndonjë gërme të emrit dhe nuk janë lejuar të votojnë, gjë që ka sjellë shumë kaos në QV-në, fluksi i madh i votuesve në momentet e fundit të votimit, etj.,²⁴

Në ndonjë qëndër të vëzhguar votimi u mbyll pas 5 orësh tej orarit të përcaktuar në ligj.

Në mbylljen e votimit kanë qënë të pranishëm vëzhguesit dhe komisionerët. Ka patur ndonjë rast ku komisionerët nuk lejonin vëzhguesit të qëndronin në qendrën e votimit për procedurat e mbylljes, pasi nuk ishin të informuar për këtë fakt.

Kutitë e votimit dhe kutitë me materialet e votimit u dërguan me makinë në qendrën e numërimit, duke respektuar kërkesat e ligjit.

Transportimi i kutive të votimit dhe materialeve të votimit është shoqëruar pa incidente. Në ndonjë rast sporadik, u vu re tension midis anetareve të komisionit lidhur me makinat e transportimit të kutive të votimit.

²⁴ Qëndrat që janë mbyllur me vonesë janë: 1896, 1927, 1785, 1897, 1804, 1805, 1806, 1807, 4448, 4507, 1949, 1741, 3014, 1759, 1861, 1708, 1714, 1723, 1723/1, 1725, etj.

11. Procedurat për numërimin e votave

Jo në të gjitha rastet **kutitë e votimit dhe kutitë me materialet e votimit** kanë mbërritur në **afatin e caktuar në qendrën e numërimit të votave**.

Sipas Kodit zgjedhor ato duhet të vijnë jo më vonë se 3 orë nga përfundimi i procesit të votimit, por ato kanë mbërritur shumë më vonë, kjo për shkak të përfundimit të votimit me vonesë, të mosmarrëveshjeve lidhur me makinat shoqëruese të kutive për në qendrën e numërimit, etj²⁵. Vonesa në kohë është shkaktuar edhe nga mungesa e mjeteve të transportit për shkak se ishte vetëm një makine e përcaktuar nga KQZ-ja për një KZZ për transportimin e të gjitha kutive të qendrave të votimit, të cilat mund të mblidhnin materialet e shumë qendrave votimi (*deri në 40 qendra votimi një KZZ*).

Kutitë e dërguara nga KQV-të janë marrë në shumicën e rasteve **në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim** që janë anëtarë të KZZ-së. Ka patur raste ku nuk janë ngritur grupe të posaçme për marrjen e kutive në dorëzim, por kanë qënë pikërisht anëtarët e KZZ-së që i kanë marrë në dorëzim ato, si në ato KZZ nr.42, etj.. Në të gjitha qendrat e numërimit, grupet e numërimit pasi kanë marrë në dorëzim kutitë e votimit dhe kutitë me materialet e votimit kanë mbajtur procesverbalin përkatës për marrjen e kutive në dorëzim. Gjendja e kutive ka qënë e mirë. Nuk ka patur kuti të thyera apo të dëmtuara në qendrat e numërimit.

Në disa qendra të numërimit të fletëve të votimit, u vunë re mosmarrëveshje midis anëtarëve të grupeve të numërimit, midis tyre e anëtarëve të KZZ-ve si dhe parregullsi të tjera, si; në një kuti votimi të një qendre votimit mungonte vula, mungonin kodet e sigurisë të ndonjë kutie votimi, etj. Në këto raste janë thirrur inspektorë të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve të cilët kanë zgjidhur rastet.

Në disa qendra, numërimi ka patur kontestime dhe vërejtje lidhur me procedurat e marrjes në dorëzim të kutive me materialet e votimit dhe kutive të votimit, pasi pretendohet se ato ishin të thyera, kodet e tyre ishin të parregullta, etj. Këto probleme janë vënë re në disa qendra numërimi²⁶.

Procesi i marrjes në dorëzim i kutive me fletët e votimit dhe i kutive me materialet e votimit në disa zona ka qënë shumë i zgjatur.

Numërimi i fletëve të votimit ka filluar me vonesë. Në disa qendra numërimi ka filluar në orët e para të mëngjesit të datës 4 korrik 2005, pasi ka patur kontestime dhe vërejtje në momentin e dorëzimit të kutive të votimit dhe kutisë me materialet e votimit.

Ka patur ankesa dhe vërejtje të ndryshme gjatë procesit të numërimit për probleme të tilla si; shënja në fletën e votimit nga një anëtar i komisionit, mosparaqitja e procesverbaleve përkatëse, përcaktimi i fletës të vlefshme apo të pavlefshme, etj²⁷.

Procesin e numërimit në disa raste është ndërprerë për shkak të lodhjes së komisionerëve, problemeve me materialet e votimit të një qendre, numërimit të ndonjë kutie të pavulosur në mënyrë të rregullt, gjetja në kuti të fletëve të votimit më të zbardhura se fletët normale të votimit, etj. Në momentet e ndërprerjes së procesit të numërimit janë thirrur inspektorë të KQZ-së për të shqyrtuar rastin konkret.

²⁵ Kjo është vënë re në disa zona Nr. 38, 34, Korçë, Vlorë, 42 (kutia e fundit ka ardhur në orën 2:45 min pas mesnate), etj..

²⁶ Si në Korçë, Pogradec, Tiranë (zonat 35, 41, 38,)

²⁷ Këto kontestime janë hasur në disa qendra numërimi si në Tiranë (41, 37, 36, 38, 32), Korçë, Pogradec, Elbasan (zona 52 dhe 55).

Ashtu si dhe komisionet e qendrave të votimit dhe anëtarët e grupeve të numërimit kishin mangësira në punën e tyre. Kjo gjëndje ishte rrjedhojë e mostrajimit të tyre të rregullt si dhe të mungesës së vullnetit politik. Patë raste sporadike kur ndaj anëtarëve të grupeve të numërimit të jenë bërë presione nga vëzhgues partiake, nga anëtarë të tjerë të grupit të numërimit, etj.

Në të gjitha KZZ-të, numërimi i votave përfundoi jashtë afatit ligjor. Vonesa në përfundimin e procesit të numërimit të votave erdhi edhe për shkak të numrit të madh të qendrave të votimit që kishte një qëndër numërimi si dhe të numrit të madh të fletëve të votimit. Me përfundimin e numërimit të votave, procesverbalet përkatëse iu dorëzuan KZZ-ve. KZZ veproi sipas ligjit lidhur me nxjerrjen e rezultatit në bazë zone.

Në qendrat e numërimit nuk mbahej qetësi e plotë gjë që ndikonte drejtëpërdrejtë në ngadalsinë e procesit të numërimit. Gjatë numërimit ka patur tension midis anëtarëve të grupeve të numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve politike

Tabela e rezultateve nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupeve të numërimit, si dhe në përgjithësi nuk ka patur kundërshtime për hartimin e tabelës së rezultateve.

8. Përfundime dhe sugjerime

Përfundime

Bazuar në vëzhgimet e KShH-së lidhur me fushatën zgjedhore dhe reformën elektorale, vëzhguesit e KShH-së për ecurinë e procesit të votimit arrijnë në përfundimet e mëposhtme:

1. Kodi i ri zgjedhor shënon një hap pozitiv në drejtim të reformës zgjedhore. Megjithatë përsëri në disa aspekte ky kod lë për të dëshiruar.
2. Puna e mbyllur (jo gjithpërfshirëse) lidhur me përgatitjen e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, vërtetoi në praktikë se zbatimi i disa dispozitave ishte i pasigurtë dhe konfuz. Praktika e rishikimit të Kodit Zgjedhor duhet të ndryshojë.
3. Ngritja dhe funksionimi i komisionit bipartisan është factor pozitiv, pavarësisht nga vonesat si për ngritjen dhe për punën e tij gjë që reflektoi në të gjithë procesin zgjedhor.
4. Vonesa në ndryshimet e kodit zgjedhor sollën vonesa në ngritjen e KZZ-ve, në përgatitjen e listave paraprake të zgjedhësve, në përgatitjen e listave përfundimtare, ngritjen e KQV-ve dhe trajnimin e tyre.
5. Politizimi i komisioneve zgjedhore u vu re edhe në zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut. Kjo kushtëzoi moszbatimin e ligjit, mosmarrëveshje të brendshme, zvarritjet në përmbushjen e detyrave. Ndikimi i partive politike mbi komisionet zonale zgjedhore ka patur ndikim negative, kjo dhe për faktin që partitë politike kanë patur të drejtën e propozimeve.
6. Profesionaliteti dhe serioziteti i anëtarëve të komisionit zonal zgjedhor, të qëndrave të votimit, dhe grupeve të numërimit lënë shumë për të dëshiruar, si shkak i të cilit mendojmë se është dhe mënyra e përzgjedhjes së tyre.
7. Listat e votuesve patën përmirësim në krahasim me zgjedhjet e tjera, kjo është vënë re jo vetëm në qytetin e Tiranës, por dhe në rrethe të tjera si në Fier, Elbasan, Gjirokastrë, Kukë, Durrës, etj.. Pavarësisht nga disa rregullime që duhen bërë, si heqja nga listat e emrave të personave të vdekur ose të larguar nga Shqipëria, rregullimi i emrave me gabime ortografike, shtimi i emrave që janë lënë jashtë listave. Për listat e zgjedhësve (më mirë se në zgjedhjet e mëparshme) përsëri me mungesë. Nuk u shfuqizuan të gjitha mundësitë për korrigjimin e tyre edhe pas shpalljes së listave përfundimtare.
8. U vunë re paqartësi lidhur me përcaktimin që ligji i bënte votimit nga votuesit sipas vendbanimit dhe vendqëndrimit. Kjo sidomos me listat e votimit për studentët.
9. Edhe në këto zgjedhje, certifikatat ishin problem shqetësues, ç'ka u konstatua para dhe gjatë procesit të votimit.
10. Zgjedhësit të cilët nuk ishin përfshirë në listat përfundimtare kishin mundësinë të drejtoheshin gjykatës deri në 6 orë para mbarimit të procesit të votimit, sipas Kodit zgjedhor.

11. Pavarësisht nga vonesa e ngritjes së KZZ-ve, sesione të plota për trajnimin e anëtarëve të KZZ u realizuan nga KQZ-ja në mënyrë profesionale.
12. Fushata zgjedhore është zhvilluar e qetë dhe pa pengesa me përjashtim të ndonjë incidenti sporadik.
13. KShH-ja përshëndeti nismën e ndërmarrë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë për hartimin e kodit të etikës si dhe nënshkrimin e tij nga të gjithë subjektet politike, megjithëse në shumë raste pati shkelje të tij.
14. Qëndrat e votimit ju ngritën sipas përcaktimeve ligjore me disa përjashtime. Ndërsa jo të gjitha komisionet e qendrave të votimit u ngirtën në afatin e përcaktuar kjo si rezultat dhe i vonesës së paraqitjes së propozimeve nga subjektet politike.
15. Gjatë këtyre zgjedhjeve u cënua parimi i fshehtësisë së votës për shkak të votimit familjar ose në grup, të dhënies së ndihmës nga një person disa votuesve, të vendosjes së dhomës së fshtë në pozicionin e përcaktuar. Këto shkaqe janë toleruar nga vetë anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit.
16. Ngritja e grupeve ë numërimit u bë konform dispozitave ë Kodit zgjedhor, por kjo kërkon një rregullim ligjor.
17. Heshtja zgjedhore nuk u respektua në datën 2 dhe 3 korrik 2005, nga shumë subjekte politike.
18. Qëndrat e votimit në disa raste u hapën me vonesë dhe kjo çoi dhe në fillimin me vonesë të procesit të votimit.
19. Në përgjithësi procesi i votimit kaloi pa incidente me përjashtim të ndonjë rasti sporadik.
20. Gjatë procesit ë votimit u vërejtën dhe persona ë cilët nuk kishin mundësi të votonin vetë dhe që në shumicën e qendrave të votimit është lejuar dhënia e ndihmës nga persona të tjera ose të afërm. Megjithatë ka patur shkelje gjatë këtyre procedurave. Ka patur dhe raste kur ndihma është dhënë dhe nga komisionerë.
21. Anëtarët e komisionit pavarësisht nga trajnimet e organizuara nga KQZ-ja, kanë qënë jo në të gjitha rastet profesionalë, rigoroz, etj,. Midis tyre ka patur tension, debate dhe mosmarreveshje.
22. Votimi u mbyll me vonesë në shumicën e qendrave të votimit.
23. Procedurat për numërimin e votave ishin të zgjatura dhe përfunduan jashtë afatit ë përcaktuar ligjor, ora 17:00, data 4 korrik 2005. Tejzgjatja e procedurave kanë ndodhur për shkak ë fluksit ë madh ë kutive të votimit, lodhja e komisionerëve, gjëndja e tensionuar ndërmjet komisionerëve, etj,.

24. Duke parë ankesat e shumta kundër vendimeve të KZZ-së pavarësisht se në pjesën dërrmuese ato u rrëzuan, të detyrojnë të arrish në konkluzionin për rishikimin e legjislacionit, madje edhe vetë sistemit zgjedhor. Është fjala për zbatimin e strategjisë që deformati proporcionalin dhe që reflektoi edhe në peshën në parlament të partive të caktuara.
25. Megjithëse ne nuk kemi të dhëna për bazueshmërinë ose jo të vendimeve të KQZ-së dhe Kolegjit Zgjedhor (pra s'mund të shprehemi për to) vëllimi kaq i madh i ankimeve mund të ketë ndikuar në cilësinë jo të duhur të shqyrtimit të tyre (kjo është vërejtje e bërë nga OSBE/ODIHR në raportin përfundimtar).
26. Kolegji Zgjedhor u zgjodh në prag të zgjedhjeve, përvoja në këtë ishte e pakët. Mendojmë se edhe në këtë drejtim Kodi Zgjedhor duhet të rishikohet.

Sugjerime

1. Megjithë përmirësimet e Kodit zgjedhor, ka ende vënd për përmirësime sidomos për procedurat në përgatitjen e procesit të votimit.
2. Sugjerojmë lidhur me atë çka është thënë dhe më sipër për rishikimin në ligj të raportit KZZ me grupe të numërimit dhe me grupe të marrjes në dorëzim. Do të sugjeronim që këto hallka të reduktoheshin dhe të përqëndrohëj më shumë përgjegjësia.
3. Lidhur me listat e zgjedhësve duhen bërë përmirësimet dhe plotësimet e duhura.
4. Bashkëpunimi i organeve të pushtetit vendor dhe KQZ-së duhet përmirësuar me qëllim për të shmangur vonesat në këtë proces.
5. Është i nevojshëm përmirësimi i procedurave të votimit me vendim gjykatë.
6. KShH-ja inkurajon zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me verifikimin e burimeve financiare të fushatës së partive politike.
7. Për të patur një proces zgjedhor sa më të mirë duhet të merren masat për përzgjedhjen sa më të mirë dhe trajnimin më eficient të anëtarëve të Komisionit zonal zgjedhor, Komisionit të qëndrave të votimit, dhe anëtarëve të grupeve të numërimit.
8. KShH-ja sugjeron gjithashtu një ndryshim në Kodin zgjedhor, në mënyrë që anëtarëve të komisioneve zgjedhore t'u lihet kohë e mjaftueshme për trajnimin e tyre. Vendosja në ligj për ngritjen e grupeve të numërimit vetëm dy orë përpara mbarimit të votimit, është tepër e dëmshme për ecurinë normale të procesit të numërimit, pasi në këtë mënyrë ata nuk kanë mundësi të trajnohen në mënyrë të plotë dhe profesionale.
9. Duhet marrë masa që organet zgjedhore që shërbejnë për administrimin sa më të mirë të zgjedhjeve, të krijohen sipas afateve ligjore të përcaktuara. Partitë politike duhet të tregojnë vullnet të mirë politik në këtë drejtim.
10. Nga vëzhgimet e bëra nga KShH-ja, mendojmë se duhet të kishte më shumë grupe numërimi në qendrat e numërimit për shkak të fluksit të madh të punës.
11. Në procesin e numërimit të votave, mendojmë se një rol të rëndësishëm duhet t'u jepet dhe vëzhguesve të organizatave vendase dhe atyre ndërkombëtare duke iu mundësuar kushte sa më të përshtatshme për vëzhgimin e këtij procesi.
12. Afatet e shqyrtimit nga KQZ dhe Kolegji Zgjedhor si dhe afati 5-ditor për ankesat kundër vendimeve të KQZ-së mund të reduktohen. Kjo do të ngushtonte afatin për shpalljen e rezultateve përfundimtare.
13. Përmirësimet e nevojshme për legjislacionin zgjedhor duhet të fillojnë sa më shpejt, për të paraprirë zgjedhjeve të ardhshme, 2006.

14. Lidhur me edukimin ligjor të zgjedhësve mendojnë se duhen marrë masa për ta zgjeruar atë tek të gjitha shtresat e shoqërisë.

Shtojca Nr. 1

Veprimtaria e KSHH-së për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare, korrik 2005

KSHH është një organizatë e cila ka vëzhguar të gjitha proceset zgjedhore që nga krijimi i saj, dhe aktualisht për vetë faktin e të qënurit pranë traktativave për hapjen e negociatave për asocimin e Shqipërië në BE, KSHH i kushtoi një vëmëndje në të veçantë procesit zgjedhor të zgjedhjeve parlamentare, korrik 2005.

KSHH gjatë vitit 2004 ka dhënë kontributin e tij për kodin e ri zgjedhor, duke bërë një sërë sugjerimesh për përmirësimin e tij. Ndërsa gjatë vitit 2005, KSHH ka ndjekur me vëmëndje të veçantë nëpërmjet raundeve të vëzhgimit, zhvillimin e procesit zgjedhor, fushatën zgjedhore, ngritjen e organeve administruese, porcesi i votimit dhe procesi i numërimit. Për shkelje procedurale dhe për moszbatim të dispozitave të kodit zgjedhor dhe të udhëzimeve të KQZ-së, KSHH ka reaguar nëpërmjet deklaratave publike, letrave drejtuar Komisionit Qëndror të zgjedhjeve, takimeve me organizata ndërkombëtare dhe vendase, opinioneve dhe artikujve të ndryshëm në median e shkruar dhe elektronike, etj.,

Publikime për sensibilizimin e shoqërisë lidhur me procesin zgjedhor

KSHH si pjesë të misionit të tij ka dhe sensibilizimin e shoqërisë për çështjet zgjedhore, të cilës i kushton një vëmëndje të veçantë. Për zgjedhjet parlamentare KSHH përgatiti broshurën informative

Nëpërmjet kësaj fletëpalosje publiku u informua lidhur me çështjet më të rëndësishme zgjedhore, për të drejtat e tyre politike, afatet ligjore, etj.,

Vëzhguesit e KSHH-së

KSHH-ja ashtu si çdo vit i kushtoi një vëmëndje të veçantë përzgjedhjes së vëzhguesve. KSHH akreditoi, trajnoi dhe aktivizoi 116 vëzhgues vendas dhe 7 të huaj.

Në këtë proces një ndihmë e madhe kanë dhënë dhe korrespondentet e KSHH-së.

Për të gjithë vëzhguesit dhe korrespondentët në datën 14 qershor u zhvillua trajnimi për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentar. Për vëzhguesit ishte përgatitur një material ndihmës për vëzhgimin e zgjedhjeve, ishin përgatitur një pyetësor për ditën e votimit si dhe për vëzhgimin e fushatës zgjedhore, etj. Në këtë trajnim u zbërthyen dhe u bënë të qarta dispozitat e kodit zgjedhor, u përcaktua metodologjia e vëzhgimit si dhe mënyra e raportimit praën KSHH-së gjatë fushatës elektorale, procesit të votimit dhe procesit të numërimit.

Konferenca për shtyp

Në datën 4 korrik 2005, u mbajt një konferencë për shtyp l për të bërë prezente përfundimet paraprake të vëzhgimiut të zgjedhjeve parlamentare, bazuar kjo në raportimet e vëzhguesve të KSHH-së.

Kjo konferencë pati një pasayrim të gjërë në median e shkruar dhe atë elektronike.

Shtojca Nr. 2

Bashkëpunimi i KShH-së me KQZ-në si dhe ndërhyrjet e vazhdueshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor

☞ Shkresa Nr.prot 102

Drejtuar: Z. Ilirjan Celibashi
Kryetar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve
Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

Nga: Vasilika Hysi
Drejtoresh Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Lënda: Lidhur me nenin 95/2 të Kodit Zgjedhor

Tiranë, më 18 Prill 2005

I nderuar Z. Celibashi,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe disa organizata të tjera jo-fitimprurëse i kanë drejtuar një letër Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë. Në këtë letër sugjerohej ndryshimi i nenit 95/2 pika 1 ku thuhet: “Për numërimin e votave në rang njësie zgjedhore, me vendim të KZZ-së..... jo më vonë se 2 orë para mbylljes së votimit.....caktohen deri në 5 grupe numërimi me shtatë anëtarë dhe një sekretar” me qëllim që të caktohej një afat deri kur partitë politike përkatëse duhet të paraqitnin propozimet për anëtarë të këtyre grupeve.

Siç duket, Kuvendi nuk e ka marrë parasysh sugjerimin e mësipërm, ndoshta me arsyetimin se nuk është e rekomandueshme që aktualisht të ndërhyhej për të bërë ndryshime në këtë apo atë dispozitë të Kodit Zgjedhor.

Është pikërisht kjo arsyeja që KSHH i sugjeron KQZ-së, që në interes të zhvillimit normal të procesit zgjedhor dhe parandalimit të vështirësive që mund të vërtetohen, si edhe në bazë të kompetencave ligjore që ai ka:

- A) Me vendim të KQZ-së të caktohen afate deri kur partitë politike përkatëse duhet t'i paraqesin KZZ-ve propozimet e tyre për anëtarë të grupeve të numërimit të votave.
- B) Me udhëzim të veçantë ose gjatë trajnimit të anëtarëve të KZZ-ve të evidentohet afati deri kur KZZ-të duhet të përcaktojnë ngritjen e këtyre grupeve.

KSHH mendon se kjo ka të bëjë me atë pjesë të nenit të mësipërm ku bëhet fjalë për caktimin “deri në 5 grupe numërimi....” Dhe si rrjedhim me faktin se partitë politike përkatëse duhet të vihen në dijeni qysh më parë se për sa grupe numërimi do të paraqiten propozimet e tyre. Kjo është e nevojshme të bëhet edhe për faktin se mund të ndodhë, të themi që një KZZ të vendosë ngritjen e tre grupeve ndërsa KZZ-ja tjetër ngritjen e pesë grupeve.

Bashkangjitur Ju dërgojmë kopjen e letrës drejtuar Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

Me respekt,
Prof.as.dr. Vasilika HYSI
Drejtoresh Ekzekutive

☞ **Shkresa nr. Prot 117**

Drejtuar: Z. Ilirjan Celibashi
Kryetar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve
Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

Nga: Vasilika Hysi
Drejtoreshë Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Lënda: Lidhur me Udhëzimin nr. 4, datë 23.03.2005 të KQZ

Tiranë, më 19 Prill 2005

I nderuar Z. Celibashi,

Në kuadër të përmirësimit të menaxhimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve të ndershme, të lira dhe demokratike, më datë 18 Prill 2005, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) i ka dërguar një letër KQZ-së lidhur me nenin 95/2 të Kodit Zgjedhor. Në këtë letër sugjerohej që në interes të zhvillimit normal të zgjedhjeve, me udhëzim të veçantë, KQZ-ja të caktonte disa afate.

Sot më datë 19 Prill 2005 u njohëm me udhëzimin nr. 4, datë 23.03.2005 të KQZ-së “Për caktimin e vendit të numërimit të votave, përgatitjes së tyre dhe mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit”.

KSHH është i ndërgjegjshëm se udhëzimet e KQZ-së kanë fuqi juridike të përgjithshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Megjithatë na lejoni të paraqesim shqetësimet e mëposhtme:

1. Në nenin 8 pika 1 thuhet: “Jo më vonë se 5 ditë përpara datës së zgjedhjeve, KZZ-ja merr vendim për numërimin e GN-ve që do të ngrëjë. KZZ-ja ua dërgon menjëherë këtë vendim partive politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të grupeve të numërimit”.

Nga kjo del se partive përkatëse politike që do të bëjnë propozimet u lihet në dispozicion më pak se 5 ditë nga data e zgjedhjeve. Duke mos përcaktuar asnjë afat për partitë politike, këto të fundit mund t’i paraqitnin propozimet edhe ditën e zgjedhjeve, ndoshta edhe 2 orë para mbylljes së votimit.

2. Sipas nenit 95/2 të Kodit Zgjedhor, kryetari, zëvendës/kryetari, anëtarët dhe sekretari i grupit të numërimit caktohen sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara për KZZ-të. Kjo do të thotë se këto kritere duhen respektuar nga partitë politike propozuese dhe duhen verifikuar nga KZZ-ja. Kemi mendimin se afati 5-ditor do të vështirësojë zbatimin e këtyre kritereve për të mos thënë se kërkesat e ligjit mund të çenohen edhe për shkak të një formalizmi të kushtëzuar nga nevoja e urgjencës së ngritjes së këtyre grupeve.
3. Në Udhëzimin e mësipërm të KQZ-së, në nenin 2 pika 1 thuhet: “Grupi i numërimit është përgjegjës **për numërimin dhe vlerësimin e tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi**”

KSHH-ja shtron pyetjen se si anëtarët e grupeve të numërimit mund ta kryejnë këtë detyrë sa të rëndësishme, aq edhe delikate në qoftë se ato ngrihen jo më vonë se 2 orë para mbylljes së votimit kur dihet se në këto kushte mundësia për trajnimin e tyre ose do të jetë e pamundur, ose do të kryhet formalisht. Sipas mendimit tonë ky proces mund të shoqërohet me pasoja të dëmshme.

Për këtë çështje, ashtu siç theksohet edhe në letrën tonë të datës 18 Prill 2005, Komiteti Shqiptar i Helsinmit dhe disa OJF të tjera i kanë drejtuar një letër Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

Letra e dytë drejtuar KQZ-së shpreh respektin dhe konsideratën për këtë institucion kushtetues të Republikës së Shqipërisë që sipas nenit 153 të saj është organi i përhershëm që përgatit, mbikqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe rezultatet e tyre.

Në përfundim sugjerojmë se në qoftë se do të ishin të papranueshme sugjerimet që përmban letra e datës 18 Prill 2005, KQZ-ja të rishikonte afatin e përcaktuar në nenin 8 pika 1 të udhëzimit të KQZ-së.

Me respekt,

Prof.as.dr. Vasilika HYSI
Drejtoreshë Ekzekutive

☞ **Shkresa Nr. Prot 123**

Tiranë, më 21 Prill 2005

Drejtuar: Z. Ilirjan Celibashi
Kryetar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve
Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

Nga: Vasilika Hysi
Drejtoreshë Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinmit

Lënda: Lidhur me Udhëzimin nr. 4, datë 23.03.2005

I nderuar Z. Celibashi,

Në vazhdim të letrës sonë nr.prot. 117, datë 19 Prill 2005 lidhur me Udhëzimin e KQZ-së nr. 4, datë 23.03.2005 “Për caktimin e vendit të numërimit të votave, përgatitjes së tyre dhe mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit” e shikojmë të nevojshme të evidentojmë edhe faktin e mëposhtëm:

1. Në pikën 1 të nenit 109/8 të Kodit Zgjedhor thuhet: “gjatë procesit të numërimit të votave në vendin e numërimit të votave janë të pranishëm: anëtarët dhe sekretarët e KZZ-së ose KZQV-së, anëtarët dhe sekretarët e grupeve të numërimit, të kandidatit, vëzhguesit duke përfshirë edhe përfaqësuesit e akredituar të medias” ndërsa në pikën 2 të nenit 6 të Udhëzimit të KQZ-së thuhet:

“KZZ-ja në mënyrë të tillë që të jetë e ndarë në mënyrë të qartë nga hapësira për vëzhguesit, kandidatët, **publikun dhe mediat** por në çdo rast pa cënuar mundësinë e ndjekjes nga afër të procesit të numërimit”.

Për sa më sipër, Komiteti Shqiptar i Helsinmit (KSHH) paraqet shqetësimet e mëposhtme:

Së pari në ligj nuk bëhet fare fjalë për praninë e **publikut**, së dyti, në ligje bëhet fjalë për përfaqësuesit e akredituar të medias dhe jo për median në përgjithësi.

2. Në pikën 2 të nenit 109/8 të Kodit Zgjedhor thuhet se: “KZZ-ja ose KZQV-ja merr masa dhe është përgjegjëse për **moslejimin e personave të tjerë në vendin e numërimit të votave, përveç atyre të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni...**”

Siç dihet, kur ka keqkuptime, pasaktësi apo mungesa, ligji ka përparësi ndaj udhëzimit sepse vetë udhëzimi mbështetet në ligj. Në këtë pikëpamje, gjatë zbatimit të nenit 109/8 pika 1 dhe 2 si edhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 23.03.2005 (neni 6 pika 2) mund të lindin keqkuptime dhe mosmarrëveshje lidhur me praninë e publikut dhe të mediave në përgjithësi (të paakredituar).

Për të parandaluar mundësinë e mosmarrëveshjeje të tilla që mund të dëmtonin sadopak procesin e rëndësishëm të numërimit të votave, do t’Ju sugjeronim të rishikohej përmbajtja e pikës 2 të nenit 6 të Udhëzimit nr. 4, datë 23.03.2005 “Për caktimin e vendit të numërimit të votave, përgatitjes së tyre dhe mënyrën e ngritjes së grupeve të nuërimit”.

Me respekt,

Prof.as.dr. Vasilika HYSI
Drejtoresh Ekzekutive

☞ **Shkresa Nr. Prot 208**

Tiranë, më 8 Qershor 2005

Drejtuar: Z. Ilirjan Celibashi
Kryetar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve
Komisioni Qëndror i zgjedhjeve

Nga: Znj. Vasilika Hysi
Drejtoresh Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Tiranë

I nderuar z. Celibashi,

Mbasi u njohëm me udhëzimin e KQZ-së Nr. 10, datë 13.05.2005, “Për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit për procesin e numërimit të votave për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë” na tërhoqi vëmëndjen përmbajtja e neneve 6 dhe 7 ku përkatësisht thuhet:

“Me marrjen e informacionit nga KZZ-të, KQZ pas sistemimit të tij, bën publikimin në dinamikë në rang zone zgjedhore. Për rezultatet e zgjedhjeve për partitë politike dhe/ose koalicionet, publikimi bëhet edhe në rang vendi. Publikimi i informacionit të mësipërm bëhet në sallën e mediave, elektronikisht e në letër dhe në faqen e KQZ-së në internet”.

Ndërsa në nenin 7 të udhëzimit thuhet: “Informacioni i publikuar nga KQZ-ja në çdo rast, shoqërohet me numrin gjithsej të QV-ve në zonën përkatëse zgjedhore dhe me numrin e QV-ve mbi të cilin është llogaritur rezultati i dhënë”.

Nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme del se KQZ-ja në bazë të informacionit nga KZZ-të ka të drejtë të publikojë rezultatet e zgjedhjeve në dinamikë në rang zone zgjedhore. Kjo do të thote se KQZ-së në bazë të këtij udhëzimi i lejohej të shpallë rezultate paraprake të zgjedhjeve.

KSHH mendon se nenet 6 dhe 7 të këtij udhëzimi në këtë drejtim bien ndesh me pikën 4 të nenit 29 të Kodit zgjedhor ku shprehimisht thuhet se KQZ “shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve

në shkallë vendi, në bazë të rezultateve të shpallura nga KZZ-ja dhe pas përfundimit të shqyrtimit të ankimeve në gjykatë. Shpallja bëhet jo më vonë se 3 ditë nga data kur KQZ-ja merr të gjitha të dhënat zyrtare nga komisionet zgjedhore dhe vendimet gjyqësore, sipas këtij Kodit...”

Për KSHH-në është e qartë se KQZ-ja ka të drejtë që në zbatim të ligjit (nenit 29 pika 1 të Kodit zgjedhor) të nxjerrë udhëzime, por mendojmë se përmbajtja e dispozitës së mësipërme nuk lejon publikime paraprake ose në dinamikë qoftë në rang njësie zgjedhore qoftë në shkallë vendi.

Me respekt,

Prof.as.dr.Vasilika Hysi
Drejtoreshë Ekzekutive

Shtojca Nr. 3

Deklaratat e KShH-së lidhur me procesin e zgjedhjeve parlamentare, korrik 2005²⁸

1. KZZ-të a do të ngrihen në 3 Mars 2005	18.02.2005
2. Kush e pengon ngritjen e KZZ-ve	23.03.2005
3. Nuk u respektua afati ligjor i shpalljes se listave zgjedhore	05.04.2005
4. Zgjedhje të lira dhe të ndërshe kur ka vullnet politik	18.05.2005
5. Mosrespektimi i afateve ligjore mund të çënojë standartet zgjedhore	25.05.2005
6. Edhe njëherë për grupet e numërimit të votave	06.06.2005
7. Zvarritje e pafalshme	13.06.2005
8. Tensionimi i situatës nuk i shërben standarteve që kërkohen	20.06.2005
9. Kur do të ngrihen Komisionet e qëndrave (KQV-të)	23.06.2005
10. Kur do të ngrihen dhe kur do të trajnohen grupet e numërimit të votave?	24.06.2005
11. Zgjedhësit dhe subjektet zgjedhore kanë të drejtën e ankimit	27.06.2005
12. Thirrje e Komitetit Shqiptar të Helsinkit	29.06.2005
13. Raport paraprak për ecurinë e procesit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare, 3 korrik 2005	04.07.2005

²⁸ Shih faqen tonë të internetit www.ahc.org.al, rubrika deklarata (versionin shqip dhe anglisht)